

Ky raport mbulon periudhën kohore janar korrik 2018, duke theksuar praktikat më të mira, parregullsitë dhe shkeljet ligjore dhe duke u fokusuar në zhvillimet kryesore në prokurim publik të nivelit lokal. Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë se deri në çfarë shkalle këto komuna veprojnë sipas ligjit, si dhe të inkurajojë zyrtarët që t'i ndajnë me të tjerët praktikat e mira në prokurimin publik.

Raporti vlerëson performancën e komunave përmes një numri indikatorësh, si: “Zbatimin e Ligjit”, “Praktikat e Mira”, “Zbatimin e rekomandimeve nga institucionet mbikëqyrëse”, “Transparencën”, “Konkurrencën” dhe “Përfshirjen Qytetare”. Bazuar në këtë analizë, D + ka gjetur që komuna e Vushtrisë, Prishtinës dhe Pejës janë performuesit më të mirë gjatë gjysmës së parë të vitit 2018.